



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 02
Prishtinë, më 29.01.2013, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2.

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novobërdali, Biserka Kostiq, Rita Hajzeraj, Kurtan Kajtazi, Kimete Bytyçi, Justina Pula, Kymete Bajraktari dhe Albana Gashi.

Munguan: Duda Balje.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinator, Sulltane Gashi - zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri-UNICEF.

Pjesëmarrës të tjerë: Florije Kryeziu-UNICEF; Blerta Aliu-Koha Ditore; Natyra Avdiu-YIHR; Lejla Selimi-OSBE; Basri Berisha-IAP.

Mbledhjen e kryesoi Suzan Novobërdali, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Njoftim lidhur me programin legjislativ të Qeverisë për vitin 2013;
3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për vitin 2012;
4. Shqyrtimi i Draftudhëzimit të Komisionit për shqyrtimin e peticioneve;
5. Të ndryshme.

Kryetarja – Konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikat e rendit të ditës.

1.Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja – Propozoi plotësimin e rendit të ditës edhe me tri pika të pashqyrtuara në mbledhjen e mbajtur, më 28 janar, si: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura, më dt. 17 dhe 18 dhjetor; Njoftim me raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me rekomandimet e dhëna në Ligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2013.

Rendi i ditës u miratua me propozimet e kryetares.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura, më dt. 17 dhe 18 dhjetor 2012

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura, më 17 dhe 18 dhjetor 2012.

3. Njoftim me raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me rekomandimet e dhëna në Ligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Kryetarja – Pasi përshëndeti të pranishmit, njoftoi komisionin me raportin dhe rekomandimet e bëra nga Institucioni i Avokatit të Popullit, për ndryshimin e dispozitave të nenit 25, të paragrafit 8, paragrafit 9 dhe paragrafit 10, të Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ajo tha se Avokati i Popullit ka pranuar një numër ankesash nga qytetarët për refuzimin e parashtresave të tyre nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, për shkak të mosparashtrimit të tyre edhe në gjuhën angleze. Në bazë të informacioneve që posedon Avokati i Popullit, këto parashtresa nuk pranohen nga kjo gjykatë, nëse një kopje e tyre nuk sigurohet edhe në gjuhën angleze, ndërsa barra e përkthimit bie mbi palët që i drejtohen asaj.

Tha se Avokati i Popullit ka paraqitur dy rekomandime, që të fillojë procedura për ndryshimin e nenit 25, paragrafit 8, paragrafit 9 dhe paragrafit 10, të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në mënyrë që ky ligj të jetë në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Po ashtu, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, të ndërpresë praktikën refuzuese dhe të kërkojë fuqizimin e shërbimeve të përkthimeve, brenda gjykatës, në mënyrë që qytetarët të mos kushtëzohen që t'i drejtohen asaj edhe në gjuhën angleze.

Kurtan Kajtazi – Duke u ndërlidhur me rekomandimet e paraqitura nga Institucioni i Avokatit të Popullit, tha se Avokati i Popullit ka paraqitur mjaft argumente për t'u

përkrahur këto rekomandime për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji dhe komisioni duhet të rekomandojë për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit në fjalë.

Albana Gashi – Tha se pajtohet që të rekomandohet për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, por duhet që Dhoma e Posaçme e Gjykatës të angazhojë vetë përkthyes, mirëpo derisa të bëhet plotësim- ndryshimi i ligjit, duhet t'i bëjmë një rekomandim kësaj gjykate, që t'i ndërpresë këto praktika të refuzimit të kërkesave të qytetarëve, për shkak të përkthimit, derisa të bëhet plotësim- ndryshimi i ligjit.

Rita Hajzeraj – Duke u ndërlidhur me parafolësit, tha se pajtohet që së pari t'i rekomandohet Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, që të ndërpresë praktikat e deritashme. Ajo tha se është një nismë e mirë e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe duhet të bashkëpunojmë, në mënyrë që të bëhet plotësimi dhe ndryshim i këtij ligji në përputhje me Kushtetutën.

Bisreka Kostiq– Lidhur me këtë raport me rekomandime, të paraqitur nga Avokati i Popullit, bëri vërejtje që nuk është i përkthyer edhe në gjuhën serbe dhe tha se ka probleme të shpeshta, pasi që nuk i ka materialet në gjuhën e saj amtare. Ajo më tej shtoi se kjo është një nismë e mirë e Institucionit të Avokatit të Popullit për respektimin e gjuhëve dhe tha se i përkrah këto rekomandime, edhe pse i mungon materiali në gjuhën serbe.

Justina Pula – Duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolëses, tha se deputetja shpesh po ballafaqohet me këtë problem, është mirë që përgjithmonë të zgjidhet ky problem, nëse nuk mund të sigurohet materiali i përkthyer me kohë, është mirë që mos të radhitet ajo pikë e rendit të ditës në mbledhje, derisa të jetë i përgatitur materiali në gjuhët zyrtare. Ajo tha se jemi Komision për të Drejtat e Njeriut dhe këto të drejta duhet të mbrohen. Sa i përket nismës së Avokatit të Popullit për ndryshim - plotësim të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, tha se të gjithë jemi për këto ndryshime.

Kryetarja – Duke u ndërlidhur me vërejtjet e anëtares së komisionit Biserka Kostiq, tha se vërejtjet e deputetes janë vërejtje me vend, sa i përket materialeve në gjuhën serbe, tha se dokumentet mos të vijnë më për shqyrtim, pa qenë të përkthyer edhe në gjuhën serbe dhe mos të na ndodhë më, që të ballafaqohemi me këtë problem.

Pas një debati konstruktiv që zhvilloi komisioni lidhur me të gjeturat nga Institucioni i Avokatit të Popullit, e që ka të bëjë me Ligjin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, komisioni lidhur me këtë nxori këtë

R e k o m a n d i m

Komisioni i rekomandon Qeverisë së Republikës së Kosovës, që të përfshijë në Programin e strategjisë legislative, plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, në mënyrë që qytetarët t'i realizojnë të drejtat e tyre në ushtrimin e kërkesave, sipas Kushtetutës dhe Ligjit për gjuhët zyrtare.

Gjithashtu, komisioni kërkon nga Këshilli Gjyqësor, që t'i ndërmarrë veprimet përkatëse për ndërprerjen e praktikave refuzuese nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, në mënyrë që qytetarët të mos kushtëzohen që t'i drejtohen asaj edhe në gjuhën angleze, derisa të bëhet plotësim- ndryshimi i Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

4. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2013

Kryetarja – Bëri prezantimin e Planit të punës së komisionit për periudhën janar-korrik 2013 dhe tha se Plani i punës është përgatitur me kohë dhe është analizuar, nëse keni ndonjë propozim, do ta shqyrtojmë dhe do ta marrim në konsideratë. Ky Plan i punës përfshin periudhën deri në kohën e pushimeve, tha se ka për të shtuar një aktivitet që është 1 Qershori- Dita Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve. Në këtë datë do të mbahet një seancë plenare, që të shënohet kjo ditë, sepse është një jehonë e mirë që të diskutohet për të drejtat e fëmijëve në Kosovë, edhe pse diskutime për të drejtat e tyre duhet të ketë vazhdimisht.

Albana Gashi – Sa i përket Planit të punës, tek monitorimi i Ligjit për personat e zhdukur, grupi i punës është i formuar me këtë përbërje: Albana Gashi, kryetare, Kimete Bytyçi, Kurtan Kajtazi dhe Rita Hajzeraj, anëtarë. Ajo gjithashtu tha se ka pasur vërejtje sa i përket respektimit të Ligjit për familjen, sidomos në pjesët që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve dhe të grave dhe tha se është mirë që të bëhet pjesërisht monitorimi i këtij ligji në ato pjesë që preken këto të drejta.

Kryetarja – Duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësës, tha se ligji ka të bëjë me Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, por ne si komision, mund të angazhohemi në monitorim, sa u përket të drejtave prindërore dhe të drejtave të fëmijëve, kështu që mund të parashihet edhe monitorimi i Ligjit për familje në këtë pjesë.

Albana Gashi – Duke u ndërlidhur prapë me Planin e punës, tha se në aktivitetet e muajit mars, ku parashihet aktiviteti për përmirësimin e kushteve të personave me aftësi të kufizuara, tha se tryezat nuk po japin rezultate dhe është mirë të dilet me një rekomandim për Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, që edhe Ligji për personat me aftësi të kufizuara të ndryshohet dhe plotësohet, sepse ka mangësi.

Kryetarja – Tha se, sa i përket këtij propozimi, ligji nuk ka të bëjë me fushëveprimin e komisionit tonë dhe nuk mund të dalim me propozime të tilla, ndërsa sa u përket aktiviteteve që janë paraparë me Planin e punës, do t'i shqyrtojmë vazhdimisht se si të realizohet ky plan i punës në mënyrën më të mirë. Ajo tha se duhet të shënohet edhe 27 Prilli- Dita për Personat e Zhdukur.

Kimete Bytyçi – Lidhur me planin e punës, tha se pajtohet që 1 Qershori- Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve, të shënohet dhe të jetë një ditë sa më festive dhe njoftoi Komisionin se, në bashkëpunim me UNICEF-in, do të mbahet një punëtori dyditore për të drejtave e fëmijëve.

Kryetarja – Tha se Planin e punës për vitin 2013, me këto plotësime që u bënë nga anëtarët e Komisionit, po e votojmë parimisht, por nëse kemi në ndërkohë aktivitete të tjera që lidhen me punët e komisionit, ky plan mund të pësojë ndryshime dhe plotësime të tjera, sipas nevojës.

Komisioni, pas shqyrtimit dhe analizimit të Planit të punës, me propozimet e bëra nga anëtarët, unanimisht miratoi Planin e punës për periudhën janar- korrik 2013.

5. Njoftim lidhur me programin legjislativ të Qeverisë për vitin 2013

Kryetarja –Prezantoi para Komisionit programin legjislativ të Qeverisë për vitin 2013 dhe tha se për këtë vit, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, ka paraparë të ketë në shqyrtim 5 projektligje.

Në plotësim dhe ndryshim do të jetë Ligji për barazi gjinore, Ligji kundër diskriminimit, Ligji për Avokatin e Popullit, Ligji për liritë fetare dhe do të bëhet hartimi i Ligjit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Ajo tha se në mbledhjet e radhës do të formohen grupet e punës për shqyrtimin e këtyre projektligjeve.

6. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për vitin 2012

Kryetarja– Tha se në Raportin e punës së Komisionit për vitin 2012, janë përmbledhur aktivitetet e Komisionit dhe është punuar në bazë të Raportit të progresit dhe Planit të Veprimit të Kuvendit, duke shtuar se është punuar edhe më shumë, sesa që është paraparë në Raportin e progresit. Ajo tha se falë punës dhe angazhimit të të gjithë anëtarëve të Komisionit, kemi arritur të hyjmë si komision i suksesshëm edhe në raportin e fizibilitetit, ku përmenden tri komisione të përhershme, si komisione të suksesshme, ku jemi edhe ne si Komision FunkSIONAL. Kjo është një e arritur e madhe e komisionit.

Rita Hajzeraj –Pasi që komisioni ka bërë një punë shumë të mirë dhe ka arritur të hyjë edhe në raportin e fizibilitetit, tha se është një arsye më shumë që të bëhet një propozim që Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, të bëhet komision i përhershëm i Kuvendit të Kosovës. Ajo tha se propozimi duhet të bëhet në një kohë sa më të shkurtër.

Kryetarja– Lidhur me propozimin e deputetes Rita Hajzeraj, tha se është një kërkesë me vend dhe se pajtohet plotësisht të bëhet një kërkesë që Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur, të bëhet komision i përhershëm .

Justina Pula– Tha se ndihet mirë që komisioni ka arritur të përfshihet në raportin e fizibilitetit, për këtë falënderoi anëtarët e komisionit për përkushtimin në punë, gjithashtu falënderoi stafin e Komisionit dhe organizatat tjera, për përkrahje të vazhdueshme të komisionit.

Pas një debati konstruktiv të zhvilluar në komision, unanimisht u miratua Raporti i punës së komisionit për vitin 2012.

7. Shqyrtimi i Draftudhëzimit të Komisionit për shqyrtimin e peticioneve

Kryetarja– Sa i përket Draftudhëzimit të Komisionit për shqyrtimin e peticioneve, në këtë draftudhëzim ka ndihmuar Reshit Gashi nga NDI, por tani jemi në dijeni se Reshit Gashi më nuk është duke punuar në NDI.

Ne, si komision, e kemi shqyrtuar njëherë këtë draftudhëzim, ndërsa ka nevojë të shqyrtohet dhe të përpunohet ende, nëse nuk kemi më përkrahje nga NDI, që na ka ndihmuar në përpilimin e këtij drafti, duhet ta përpunojmë vetë si komision dhe ta miratojmë në mbledhjet e radhës, por duhet parë mënyrën se si të veprohet për këtë draftudhëzues.

8. Të ndryshme

Biserka Kostiq–Tha se kohëve të fundit kanë ndodhur shkelje të të drejtave të njeriut, duke përmendur rrënimin e varrezave serbe. Ajo tha se kjo është një situatë e papranueshme, varësisht se çka ndodh në politikë.

Ajo falënderoi Qeverinë e Republikës së Kosovës që ka dalë në terren dhe ka bërë ndarjen e mjeteve, që të sanohen dëmet.

Kryetarja– Duke u ndërlidhur me parafolësen, tha se Qeveria ka bërë reagimin e vet, duke dënuar sulmin dhe tha se duhet dënuar çdo sulm, pavarësisht ndaj kujt ndodh.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novobërdali